



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2022:138126

Datë: 05.09.2024

Numri i dokumentit: 06128555

C.nr.547/2022

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Bajram Cacaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F. Gj., nga K. e J., të cilën me autorizim e përfaqëson I. R., avokat në Gj., kundër të paditurës Komuna e Junikut, Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, me seli në Junik, të cilën me autorizim e përfaqësojnë N.S., F.L. dhe S.B., avokatë në P. si dhe juristet A. A, dhe U. R., në çështjen juridike kompensim i shujtave ditore, me vlerë të kontestit 1.104,00 €, jashtë seancës, më datë 05.09.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses F. Gj. dhe DETYROHET e paditura Komuna e Junikut, Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, që paditëses në emër të shujtave ditore, për 451 ditë punë, për periudhën kohore nga data 06.07.2019 e deri me datën 31.12.2021, t'ia kompensoj shumën në lartësi prej 902,00 €, me kamatë ligjore prej 8% nga data 06.07.2022 (data e paraqitjes së padisë) deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 110,00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi shumën e gjykuar si në pikën I të këtij aktgjykimi dhe atë në shumë prej 202,00 €, si e PABAZUAR.

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarit të saj në padinë e parashtruar në gjykatë me datë 06.07.2022, ndër të tjera ka theksuar se paditësja ka qenë e punësuar pranë të paditurës dhe atë në shkollën "E.... H...." në J. dhe nga data 21.11.2018 e deri më datën 31.12.2021 e paditura ka qenë e obliguar që konform Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë paditëses t'ia kompensoj shumën prej 2 euro, për çdo ditë punë, e kjo në emër të shujtave dhe për periudhën e lartcekur sipas kalendarëve zyrtarë të Ministrisë së Arsimit paditësja ka punuar 552 ditë pune, prandaj ka kërkuar nga gjykata që të detyroj paditurën që paditëses në emër të shujtave në punë t'ia

kompensoj shumën prej 1.104,00 €, së bashku me kamatën ligjore, si dhe shpenzimet e procedurës.

E paditura përmes përfaqësuesit të saj, me përgjigje në padi e ka kontestuar tërësisht padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, si për nga baza, ashtu edhe nga lartësia, duke propozuar që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pabazuar dhe kjo për faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e vitit 2017 dhe ajo e vitit 2021 nuk prodhojnë efekt juridik ngase ekziston njoftimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministria e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për shkëputjen e kontratës Kolektive. Po ashtu kjo kërkesë është vjetërsuar apo parashkruar konform nenit 87 të Ligjit të Punës, ku thuhet se “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tre (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Tutje ka pretenduar se kompensimi i tillë nuk është paraparë as me Ligjin e Punës, as me Ligjin për Shërbyesit Civil dhe as me Ligjin për Pagat. Dhe si rezultat i kësaj e paditura gjatë përgatitjes së buxhetit nuk ka paraparë në skemën e saj buxhetore linjë të veçantë për këtë lloj të kompensimit, andaj ka propozuar që të refuzohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditëses. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestuese se e paditura në periudhën kohore nga data 26.12.2018 e deri më datën 31.12.2021 ka qenë e punësuar tek e paditura, konkretisht në shkollën “E... H.” në J., në cilësinë e arsimtares së parashkollorëve, fakt i cili vërtetohet edhe nga vërtetimi me numër të protokollit 01/15 të datës 26.01.2022 i lëshuar nga Shkolla Fillore “E... H.”, po ashtu edhe nga listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës në emër të paditëses.

Po ashtu nuk ishte kontestuese se paditësja në periudhën e lartcekur kohore kishte gjithsej 552 ditë punë, fakt i cili vërtetohet edhe nga Kalendarët Zyrtar të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitet shkollorë 2018-2019, 2019-2020 dhe 2020-2021.

Provave të lartcekura gjykata iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjeti se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e dy Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruara në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, të vitit 2017 (e aplikueshme nga

data e aplikueshme nga data 18.04.2017-21.01.2021) dhe asaj të vitit 2021 (e aplikueshme nga data 22.01.2021-21.11.2022), e në të cilat është përcaktuar se: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) € për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restorantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim pagese (2 €), të te punësuarve për ushqim për ta bërë kompensimin”* (neni 35 par. 7 i Kontratave Kolektive të lartcekura), por se duhet të vendoset si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe se paditëses t’i njihet e drejta për kompensimin e shujtave ditore në punë vetëm për periudhën nga data 06.07.2019 e deri me datën 31.12.2021, për faktin se periudha tjetër kohore nga data 26.11.2018 e deri më datën 05.07.2019 është e përfshirë në parashkrim konform nenit 87 të Ligjit të Punës, ashtu sikurse me të drejtë pretendon e paditura në përgjigje në padi, andaj gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e themeltë dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit bëri përlllogaritjen në atë mënyrë që ditët e pranisë në punë për periudhën e aprovuar prej 451 ditë punë, të cilat ditë vërtetohen në bazë të Kalendarëve Zyrtar të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitet shkollore 2018-2019, 2019-2020 dhe 2020-2021, i ka shumëzuar me dy, duke ia njohur shumën prej 902,00 €.

Duke qenë se gjendja faktike nuk është kontestuese në mes të palëve, pasi që e paditura në asnjë formë nuk e ka kontestuar faktin se paditësja ka qenë e punësuar tek e paditura dhe se të njëjtës për periudhën e lartcekur nuk i janë kompensuar shpenzimet në emër të shujtave në punë, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi pretendimin në përgjigje në padi se në rastin konkret Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë të vitit 2017 dhe 2021 nuk prodhojnë efekt juridike, për faktin se Qeveria e Republikës së Kosovës, konkretisht Ministria e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me njoftimin numër OIB/488 të datës 21.11.2022, ka bërë shkëputjen e të njëjtës, por vlerësoj se ky pretendim është i pabazuar për faktin se kërkesa është parashtruar për periudhën kohore konkretisht vitet 2018, 2019 dhe 2021, ndërsa njoftimi për shkëputje të kontratës ka prodhuar efekt pas kësaj periudhe kohore konkretisht nga data 21.11.2022, kështu ka vlerësuar edhe Gjykata Supreme e Kosovës në mendim e saj juridik GJ.A.214/2023 të datës 05.10.2023.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadiisë me arsyetimin se Ligji i Punës, Ligji për Shërbyes Civil, Ligji për Pagat, nuk e kanë paraparë pagesën për një kompensim të tillë, mirëpo këta pretendime gjykata i refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadiisë sikurse u tha më lartë rrjedh nga Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë të viteve 2017 dhe 2021.

Ndërsa sa i përket pretendimeve lidhur me mungesën e buxhetit edhe këto pretendime sipas vlerësimit të gjykatës janë të pabazuara dhe nuk gjejnë mbështetje në asnjë normë ligjore të aplikueshme, e për më tepër gjykata i vlerësoi si të parëndësishme për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike kontestuese, pasi që paditësja nuk është përgjegjës për planifikimin e buxhetit për obligimet që dalin nga Kontrata Kolektive, andaj edhe rrethanat subjektive të të paditurës lidhur me mos planifikimin me kohë të buxhetit, për zbatimin e detyrimeve që falin nga Kontratat Kolektive nuk e lirojnë të njëjtën nga detyrimi për pagesën e këtyre shpenzimeve.

Sa i përket pretendimit të dhënë në përgjigje në padi se në rastin në fjalë kemi parashkrim të kërkesës në tërësi, ky pretendim rezulton i pabazuar sa i përket periudhës prej datës 06.07.2019 e deri me datën 31.12.2021 pasi që konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret duke pasur parasysh se padia është paraqitur me datë 06.07.2022, rezulton se për periudhën e lartcekur, padia është paraqitur brenda afatit prej tre viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Ndërsa lidhur me pjesën tjetër të kërkesëpadisë përkitazi me kompensimin për shujta në lartësi të kërkesës prej 202,00 €, gjykata vendosi sikurse në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit pasi që pretendimet e përfaqësuesit të të paditurës në lidhje me parashkrimin e kërkesës, i morri pjesërisht si të bazuara pasi që sipas provave të administruara vërtetohet se paditësja kërkesën e saj për kompensim në emër të shujtave për këtë lartësi të kërkesës e ka parashtruar pas afatit kohor prej 3 (tre) viteve siç parasheh neni 87 i Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, i cili ka përcaktuar që *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, ashtu që në rastin konkret gjykata ka vërtetuar se kërkesëpadia e paditëses për 101 ditë punë të vitit shkollor 2018-2019 (muajt nëntor 2018 deri qershor 2019) të konstatuara sipas Kalendarit Zyrtar të MASHT për vitin shkollor 2018-2019, janë të përfshira në parashkrim, për faktin se paditësja padinë e ka parashtruar me datë 06.07.2022, që nënkupton më shumë se tri vite nga lindja e të drejtës për kërkesën nga marrëdhënia e punës, përkatësisht lidhur me kompensimin e shujtave në punë, andaj gjykata refuzoj si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses për kompensim të shujtave në punë.

Gjykata vendosi sikurse në pikën II të dispozitivit, duke pasur parasysh se edhe në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, gjykata e morri sipas nenit 449 dhe 452 par. 2 të LPK, duke pasur parasysh suksesin në procedurë, me ç' rast paditëses iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 110,00 €. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 30,00 €, si dhe për përpilimin e padisë shuma prej 80,00 €.

Nga të lartcekurat, gjykata bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA THEMELORE PEJË

Dega në Deçan

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.547/22, më 05.09.2024

Gjyqtar

---

Bajram Cacaj

#### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplarë të mjaftueshëm për palët dhe gjykatën.